



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBETARE E PERMBARUESVE GJYQESOR PRIVAT
ZYRA E PERMBARIMIT PRIVAT « ENFORCEMENT GROUP» SHPK

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla Nr.1. Pall. e Shoqërisë "GORA" Kati IV, Ap.14, Fierane Tel: 0672022667

e-mail : enforcementgroup2014@gmail.com

Nr.293/4 Prot.

Nr. 2394 Regj

Fier, më 12.04.2024



URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE
MBI KUOTAT E DEBITORIT

Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Biznesit

Për Dijeni: Shoqëria "Spektri" sh.p.k , me nr NIPT J62903555F

Adresa: Lagjia "Konferenca e Pezës", Fier

Për dijeni: Shoqëria " Climatherm" sh.p.k me Nipt L42728401F

Adresa: Lagjia "Sheq i vogel", Rruga "Murialdo", Fier.

Unë Engjell Muskaj me detyrë Përmbarues Gjyqësor Privat pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Enforcement Group" shpk, pasi studiova materialet e dosjes me Nr. 2394 Regj, bazuar ne Urdhrit e Ekzekutimit Vendimi nr 62-2023-5250 (759) datë 21.12.2023 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit te Përgjithshëm Fier,

K O N S T A T O V A:

Se pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Enforcement Group" shpk, është depozituar për Ekzekutim, kërkesa e kreditorit Shoqëria " Climatherm" sh.p.k me Nipt L42728401F, së bashku me Titullin Ekzekutiv faturë tatimore Nr. 181/2022 datë 29.04.2022, për të cilën ka dalë Urdhri i ekzekutimit Vendimi nr 62-2023-5250 (759) datë 21.12.2023 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit te Përgjithshëm Fier , me palë e objekt:

Kreditor: Shoqëria " Climatherm" sh.p.k me Nipt L42728401F

Debitor: Shoqëria "Spektri" shpk , me nr NIPT J62903555F

Objekti: Pagim shume

Me anë të këtij Urdhri ekzekutimi është vendosur :

1.Pranimin e kërkesës

2-Lëshimi i Urdhrit të ekzekutimit për faturën tatimore Nr. 181/2022 datë 29.04.2022, me vlerë 3,140,280 lekë të lëshuar nga ana e :

Kreditorit : Shoqëria " Climatherm" sh.p.k , person juridik , me Nipt L42728401F, dhe adresë lagje "Sheq I vogel", Rruga "Murialdo",Fier, perfaqesuar nga administrator Z. Dashnor Bregu me prokure te posacme me Nr. 1196 rep, Nr.618 kol , date 19.04.2023 nga Av. Gazmend Pashaj , anëtar I dhomës së avokatisë Fier, që shprehin detyrimin e Debitorit : Shoqëria "Spektri" shpk , me nr NIPT J62903555F , me adresë lagje Konferenca e Pezës , Fier per shumën prej 3,140,280 lekë , si dhe mbi këtë detyrim të përlllogariten nga përmbaruesi gjyqësor ne fazen e ekzekutimit kamat ligjore ne përputhje me legjislacionin në fuqi .

3-Ngarkohet sherbimi permbarimor te beje ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

4-Shpenzimet gjyqësore ne Shumen 200 lekë I ngarkohen kerkuesit.

Në kushtet kur debitori nuk e shleu vullnetarisht detyrimin atëherë nga ana jonë në bazë të nenit 519 K.P.Civile kemi vijuar me procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm duke vendosur sekuestro mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të palës debitore.

Me qëllim vijimin e procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm dhe ekzekutimin e Urdhrit të ekzekutimit të sipërcituar, duhet vijuar dhe me vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi kuotat e debitorit.

Për sa më sipër:

Në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

URDHËROJ:

- 1.Vendosjen e masës së sekuestros konservative në kuotat e debitorit Shoqëria "Spektri" shpk , me nr NIPT J62903555F .
2. Kuotat e mesiperme do te qendrojne te sekuestruara deri ne nje urdher te dyte nga ana e zyres sone permbarimore.
- 3.Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet te na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- 4.Per personat që bëhen pengesë ne zbatimin e ketij urdheri do të merren te gjitha masat e parashikuara ne neni 606 te K.Pr.Civile, si dhe ne rast se ka vend do te kerkohet ndjekje penale ne baze te dispozitave te Kodit Penal.
- 5.Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 te K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.
- 6.Pas dergeses se ketij urdheri per vendosjen e sekuestros konservative mbi aksionet e debitorit te sipercituar ne shoqerite e sipercituara, kerkojme te na dergohet prane zyres sone statusi i aksioneve pas kryerjes se bllokimit, brenda afatit ligjor.

ZYRA E PERMBARIMIT PRIVAT "ENFORCEMENT GROUP" SHPK

PËRMBARUESI GJYQËSOR

ENGJELL MUSKAJ

